



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KLOS

Nr. 3233 Prot.

Klos, më 24 / 11 . 2023

PROJEKT VENDIM

Nr. \_\_\_ Datë \_\_\_ / \_\_\_ /2023

PËR DHËNIE MENDIMI PËR FILLIM PROCEDURASH PËR DHËNIE NË PËRDORIM  
NGA FONDI PYJOR I SIPËRFAQEVE TË KËRKUARA NGA SUBJEKTE PRIVATE.

Mbështetur ne "Ligjin 139/2015" për vetqeverisjen vendore "Neni 54" shkonja "e" dhe "K", në ligjin nr 48/2016, VKM. 433, datë 08.06.2016, në zbatim të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, "Për Pyjet" në "VKM. Nr. 888, dt. 27.12.2022, "Për Rastet e Dhënies në Përdorim dhe Nryshimin e Kategorisë së Përdorimit, Procedurat dhe Dokumentacioni Përkatës për Ndryshimet e Sipërfaqeve dhe Pakësimin në Volum nga Fondi PyJOR Kombëtar apo Zgjerimi i tyre", Udhëzimit të Ministrit nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyJOR dhe kullusor publik" dhe V.K.M-së nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të fondit pyJOR dhe kullusorë publik", me vendim të Këshillit Bashkiak, brenda territorit Administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore e cila do ti nënshtrohet procedurave të dhënies, i kërkojmë këshillit të Bashkisë të,

VENDOSË:

Miratimin për fillimin e procedurave, për dhënie në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyJOR i kërkuar nga subjekti privat.

**SHOQËRIA "SPV SITROF ENERGY AND CONSTRUCTION" Shpk.**

**NIUS. M31925015J.** Sipërfaqja e kërkuar është 34.4 ha, në Nënngastrat nr.11a, 12a.

**Ekonomia Pyjore Mali i Benjës-Cerujë,**

**Zona Kadastrale: 2887.**

**Kodi Kadastral: DI 3400 11a, DI 3400 2a.**

Përdorimi i sipërfaqes: Ndërtim të Parkut Fotovoltaik për prodhimin e energjisë elektrike.

**KRYETARI I BASHKISË**

Valbona KOLA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KLOS**  
**DREJTORIA E ZHVILLIMIT TE BUJQËSISË DHE PYJEVE**  
**SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE.**

Klos, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023

**RELACION SHPJEGUES**

**PËR DHËNIEN E MENDIMIT PARAPRAK PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE, PËR DHËNIE NË PËRDORIM, TË SIPËRFAQES SË KËRKUAR, NGA SHOQËRIA “SPV SITROF ENERGY AND CONSTRUCTION ” shpk. PËR NDËRTIMIN E PARQEVE FOTOVOLTAIKE TË GJENERIMIT TË ENERGJISË DIELLORE NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR.**

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Klos**

Ky relacion është hartuar duke u bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020 datë 20.04.2020 "Për Pyjet" , V.K.M-në nr. 434, datë 08.06.2016 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa” në vendimin nr. 1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe kriterëve e procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”. Udhëzimit të Ministrit nr.1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullusor publik” dhe V.K.M-së nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të fondit pyjor dhe kullusorë publik” si dhe referuar kërkesës së SHOQËRISË “SPV SITROF ENERGY AND CONSTRUCTION” sh.p.k, protokolluar në Bashkinë Klos me nr. 2785 prot., datë 16.10.2023.

Të nderuar Këshilltarë,

Në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe VKM nr. 822 datë 07.10.2015“, pika h, për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”.

Nisur edhe nga inisiativa e Qeverisë për nxitjen e prodhimit të energjisë së rinovueshme, shoqëria "shoqëria "spv sitrof energy and constrction" shpk., synon zhvillimin e projekteve për ndërtimin e parqeve fotovoltaike për prodhim të energjisë elektrike në Ekonominë Pyjore Mali i Benjës-Cerujë, ngastrat nr. 11a dhe 12a, pjesë e teritorit të Bashkisë Klos.

Procedurat që ndiqen për dhënien me qera në fondin pyjor /kullor publik janë mbështetur në VKM. Nr. 888, datë 27.12.2022, "Për Rastet e Dhënies në Përdorim dhe për Ndryshimin e Kategorisë së Përdorimit, Procedurat dhe Dokumentacioni Përkatës për Ndryshimet e Sipërfaqeve dhe Pakësimin në Volum Nga Fondi Pyjor Kombëtar apo zgjerimin e tyre", në pikën 22 dhe 28, të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06 2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", dhe bazuar në kërkesën e subjektit "shoqëria "spv sitrof energy and constrction" shpk., për marrje me qera të një sipërfaqje pyjore, pronë e Bashkisë Klos për "Ndërtim të parkut fotovoltaik për prodhimin e energjisë diellore", në VKM nr. 559, datë 29.07.2022,"Për caktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër subjekti kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur vetëm pas lidhjes së kontratës me Bashkinë Klos.

#### **Pagesa fillon pas marrjes së lejes së ndërtimit.**

- Ndërtim të parkut fotovoltaik të energjisë diellore:

1.Tarifë në Inproduktive  $34.4 \text{ ha} \times 176000 = 4919200$  (katër milion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë. (Shtojca nr. 1, pika 8) për 'Ndërtim Teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogjeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj.) ".

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

P/Sektorit të Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave

Ing. Kapllan Allamani

